

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-300 Level

PRODUKT ME BAZË ÇIMENTOJE DHE I MODIFIKUAR ME POLIMERE PËR NIVELIMIN E DYSHEMESË PËR 1-10 MM, C30-F7.



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Produkt me çlirime shumë të ulëta, bazë çimentoje dhe i vetënivelueshëm për të gjitha nënshtresat e përshtatshme për shtrim. Për përdorim në mjedis të brendshme. Sikafloor®-300 Level mund të karakterizohet si një përbërës nivelimi me finiturë të lëmuar, për ngarkesa mesatare, tkurrje shumë të ulët dhe veti shumë të mira vetënivelimi.

PËRDORIMET

Sikafloor®-300 Level është i përshtatshëm për mbushje, lëvim dhe nivelim të nënshtresave të përshtatshme përpara aplikimit të parketit, pllakave qeramike, dyshemeve prej rrëshire pa fuga, mbulimeve tekstile elastike të dyshemeve për mjedis të brendshme në zona rezidenciale dhe joindustriale.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- I vetënivelueshëm
- I përshtatshëm për aplikime në sistemet me ngrohje nën dysheme
- Trashësi shtrese deri në 20 mm me agregate
- I përshtatshëm për ngarkesën e karrigeve me rrota të zyrave në trashësi shtrese > 1 mm sipas EN 12 529
- I pompueshëm
- Nivel i lartë fortësie dhe rezistence
- Porozitet i ulët i sipërfaqes
- Finiturë shumë e lëmuar
- Mund të bluhet mirë
- I modifikuar me polimere
- Tharje nëpërmjet hidratimit
- Kapacitet i lartë nivelimi të parregullsive të sipërfaqes
- Transmetim i ulët tensioni tek nënshtresa

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- EC 1 PLUS R: çlirime shumë të ulëta.

MIRATIME / STANDARDE

- Llaç çimentoje për nivelim CT-C30-F7 sipas EN 13813, DoP 115041501, dhe mbart markën CE.
- Llaç çimentoje për nivelim sipas EN 13813, kategoria A1/A1fl sipas EN 13501-1, DoP 115041501, vlerësuar nga laborator i njoftuar 1378, dhe mbart markën CE.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

| | |
|-----------------------|--|
| Baza kimike | Me bazë çimentoje, i modifikuar me polimere |
| Ambalazhi | Thes letre 25 kg |
| Paraqitja / Ngjyra | Gri |
| Jetëgjatësia | 6 muaj nga data e prodhimit |
| Kushtet e magazinimit | Thasët e hapur duhet të mbyllën menjëherë dhe të përdoren sa më shpejtë të jetë e mundur. Të mos magazinohet nën +5°C. |

TË DHËNA TEKNIKE

| | | |
|---------------------------------------|---|--------------|
| Rezistenca ndaj ngjeshjes | ≥30 N/mm ² (28 ditë në 23°C) | (EN 13892-2) |
| Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje | ≥7 N/mm ² (28 ditë në 23 °C) | (EN 13892-2) |

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

| | | |
|--|---|---|
| Raporti i përzjerjes | Sikafloor®-300 Level | ~6.3- 6.5 l ujë për 25 kg Sikafloor®-300 Level |
| | Sikafloor®-300 Level me agregate | shtoni 16 kg ose 10 L rërë kuarci 0.1–3.0 mm për 25 kg Sikafloor®-300 Level (~65% për peshë) ≤ 6.5 L ujë për 25 kg Sikafloor®-300 Level |
| Konsumimi | ~ 1.5 kg/m ² /mm. | |
| Trashësia e shtresës | Sikafloor®-300 Level | 1–10 mm |
| | Sikafloor®-300 Level me agregate | 10–20 mm |
| Temperatura e mjedisit | +5 °C min. / +30 °C max. | |
| Lagështia relative e ajrit | < 75% | |
| Temperatura e nënshtresës | +5 °C min. / +30 °C max. | |
| Përgatitja e nënshtresës | Nënshtresa | Prajmer |
| | Nënshtresa me absorbueshmëri normale si betoni, llaçet e çimentos, llaçet e çimentos me mpiksje të shpejtë | Sikafloor®-01 Primer (1:3) ose Sikafloor®-03 Primer |
| | Nënshtresa sulfati kalciumi (gipsi) ¹ | Sikafloor®-03 Primer ose Sikafloor®-01 Primer (1:1) |
| | Nënshtresa jo absorbuese si nënshtresat e lyera me prajmer dhe me mbetje adezivësh të vjetër rezistentë ndaj ujit | Sikafloor®-02 Primer ose Sikafloor®-01 Primer |
| | Pllaka zdrukthi | Sikafloor®-03 Primer ose Sikafloor®-01 Primer |
| | Dysheme magnezi (jo ksiloliti-xylolite) | Sikafloor®-02 Primer |
| <p>1. Nëse trashësia e shtresës së Sikafloor®-300 Level i kalon 10 mm lyheni nënshtresën prej sulfati kalciumi (gipsi) dy herë me prajmerin Sikafloor®-155 WN. Nëse Sikafloor®-155 WN nuk spërkatet plotësisht me rërë kuarci (0,2 - 0,8 mm), përdorni Sikafloor®-02 Primer përpara aplikimit të Sikafloor®-300 Level.</p> | | |
| Koha e punueshmërisë | ~30 min. në +20 °C | |

| Veshja/ mbulimi | Trashësia e shtresës | Koha e pritjes |
|--|----------------------|----------------|
| Të gjitha llojet e veshjeve/ mbulimeve | ≤ 5 mm | ~24 orë |
| Të gjitha llojet e veshjeve/ mbulimeve | ≤ 10mm | ~48 orë |
| Veshje qeramike (dhe Sikafloor®-300 Level i aplikuar mbi beton dhe llaçe çimentoje, në mjedise të brendshme) | ≤ 20 mm | ~3 orë |

Të gjitha vlerat jepen me përafërsi dhe janë subjekt i ndryshimeve klimatike. Vlerat jepen në 20°C dhe lagështi relative 65%, temperaturë nënshtrese +15°C.

Gjatë mbulimit të Sikafloor®-300 Level sigurohuni gjithmonë se përmbajtja e lagështisë ka arritur vlerën që kërkohet nga produkti me të cilin do të bëhet mbulimi, pasi koha e pritjes do të variojë sipas trashësisë së aplikimit dhe lagështisë së ambientit. (Referohuni tek skeda teknike e produktit të mbulimit).

Produkti i aplikuar gati për përdorim

Gati për qarkullim këmbësorësh pas ~ 3 orësh

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

- Nënshtresa të përshtatshme janë: Betoni, çimentoja dhe llaçet e çimentos me ngurtësim të shpejtë, llaçet me bazë sulfati kalciumi (gipsi), pllakat qeramike dhe gurët natyrorë, llaçet e magnezit, llaçet mastiku asfaltik (IC10, IC15 sipas EN 13813), dërrasa të përpunuara të vidhosura dhe pllaka zdrukthi. Kërkesat për nënshtresën:
 - Rezistencë e mjaftueshme, kapacitet për bartje ngarkese, qëndrueshmëri përmasash dhe thatësi e përhershme.
 - Duhet të jetë e qëndrueshme dhe e pastër, pa kontaminues, si p.sh. pluhur, ndotje, vaj, graso dhe grimca të lira.
 - Shtresat ndarëse, korja e çimentos dhe kontaminues të tjerë duhet të hiqen me mjetet e përshtatshme si smerilizim, rrymë rëre, pastrim me rrymë abrazive, bluarje ose pastrim tërësor.
 - Shtresat niveluese të vjetra, të lira dhe të dobëta duhet të hiqen mekanikisht.
 - Materialet për trajtimin e sipërfaqes apo çdo zonë e shkrifët duhet të hiqen mekanikisht dhe mbushja e vrimave dhe hapësirave duhet të bëhet me p.sh. Sika® Patch-5.
 - Shtresat prej adezivësh të tretshëm në ujë, p.sh. adezivë me mbetje sulfitesh, duhet të hiqen mekanikisht. Mbetjet e adezivëve duhet të lyhen me prajmerin Sikafloor®-155WN/-156/-160/-161 ose Sika® Primer MB Rapid. Nëse ky prajmer nuk spërkatet plotësisht me rërë kuarci, Sikafloor®-02 Primer duhet të përdoret përpara aplikimit të Sikafloor®-300 Level.
 - Adezivët e vjetër rezistentë ndaj ujit duhet të hiqen mekanikisht sa më shumë të jetë e mundur.
 - Shtresat e vjetra prej pllakash qeramike dhe gurësh natyrorë duhet të shtrohen mirë, të pastrohen plotësisht dhe në fund të bluhën (gërryhen).
 - Llaçet prej mastiku asfaltik IC10 dhe IC 15 sipas EN

- 13813. Sikafloor®-300 Level duhet të ketë trashësi të paktën 1.5 mm dhe nuk duhet të tejkalojë 3 mm. Mastiku asfaltik duhet të spërkatet plotësisht me rërë kuarci (sipërfaqe e ashpër). Nëse sipërfaqja është e lëmuar (spërkatje e pamjaftueshme ose sipërfaqje e vjetër dhe e përdorur) përdorni prajmerin Sikafloor®-02 Primer ose Sikafloor®-01 Primer të paholluar përpara aplikimit të Sikafloor®-300 Level.
- Përdorni Sikafloor®-01/-02/-03 Primer, prajmer akrilik me një përbërës për një sipërfaqe pa pore me ndërkapje shumë të mirë. Ju lutemi lexoni skedën teknike përkatëse.
- Mos aplikoni mbi nënshtresa me lagështi në rritje. Nëse ndodh rritja e lagështisë, duhet të aplikohet një membranë efikase kundër lagështisë dhe të jetë në përputhje me standardet kombëtare.
- Përpara aplikimit konfirmoni se dërrasat ose pllakat e zdrukthit janë të fiksuara mirë dhe nuk lëvizin. Sipërfaqja e dërrasave duhet të smerilizohet. Parandaloni rrjedhjen e Sikafloor®-300 Level në fuga, plasaritje ose vrima.
- Duhet të zbatohen kërkesat e standardeve përkatëse në fuqi, udhëzimet dhe të dhënat në skedat teknike.

PËRZIERJA

Hidhni Sikafloor®-300 Level në ujë të ftohtë dhe të pastër brenda një konteineri të pastër dhe përzieri për ~2 minuta derisa të përftohet një miks homogjen. Rekomandohet përdorimi i një përzierësi me shufër rrotulluese. Pas një kohe të shkurtër maturimi, përzieri plotësisht edhe një herë. Shënim: Mos përzieri Sikafloor®-300 Level me çimento ose produkte të tjera me bazë çimentoje. Në rast se do të shtohen agregate, shtimi i tyre duhet bërë pasi është përzierë pluhuri me ujin (në fund të procesit të përzierjes).

APLIKIMI

- Pas përzierjes hidhni produktin nivelues dhe përhapeni me një mallë të dhembëzuar, krëhër (screed rake) ose nivelues me gjilpërë. Me përdorimin e niveluesit me gjilpërë zakonisht nuk kërkohet korrigjimi i defekteve nga malla me rulin me gjemba ose të nivelim më shumë se një herë.
- Fugat e skajeve dhe të lëvizjes duhet të sillen në të njëjtin nivel me sipërfaqen e përfunduar dhe duhet të mbrohen nga rrjedhja e produktit të nivelimit brenda tyre.
- Punimet e nivelimit duhet të aplikohen në trashësi të mjaftueshme dhe rrafshësi sipërfaqeje, siç kërkohet nga prodhuesi i pllakave ose finiturës së dyshemesë.
- Në rast të trashësisë së madhe të shtresës, kontakti me strukturat vertikale duhet të shmangët duke vendosur një shirit izolues në perimetër.
- Nëse do të aplikohet shtresë e dytë e produktit nivelues, shtresa e parë e tij duhet të lyhet me prajmerin Sikafloor®-03 Primer ose me Sikafloor®-01 Primer (1:1). Nuk duhet tejkualuar trashësia maksimale e shtresës edhe në rastin e aplikimit në dy shtresa. Trashësia e shtresës së dytë nuk duhet të kalojë trashësinë e shtresës së parë.
- Duhet të shmangët kontakti me metale si tubacionet që bartin ujë (p.sh. mbyllja e depërtimeve të tubacioneve), sepse tubacionet prej çeliku posaçërisht të galvanizuara nuk kanë mbrojtje të mjaftueshme ndaj korrozimit.
- Mbroni shtresat niveluese të Sikafloor®-300 Level gjatë maturimit nga temperaturat e larta të ambientit, rrezatimi diellor i drejtpërdrejtë dhe thatësia.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat dhe mjetet e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / maturuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

DOKUMENTA SHITESË

Duhet të respektohen rekomandimet, udhëzimet, Standardet Europiane, rregulloret dhe Fletët me të Dhënat e Sigurisë të zbatueshme, së bashku me rregulloret e njohura arkitekturore dhe inxhinierike.

KUFIZIME

- Llaçet e vjetra mastiku asfaltik IC10 dhe IC15 (EN 18813) shpesh kanë plasaritje ose janë të thyeshme. Kjo nënshtrësë nuk ka rezistencë të mjaftueshme për aplikim të llaçit vetënivelues me bazë çimentoje dhe sforcimi të ulët sipër saj. Në këtë rast këshillohet përdorimi i përbërësit për nivelim me bazë gipsi që nuk ushtron sforcim.
- Aplikoni shtresë të vetënivelueshme llaçi me trashësi minimale shtresë 2 mm kur do të vijojë mbulimi me parket.
- Aplikoni shtresë të vetënivelueshme llaçi me trashësi minimale shtresë 4 mm kur do të vijojë mbulimi me sistem dyshemeje me rrëshirë.
- Në vendet ku Sikafloor®-300 Level do të mbulohet me dysheme rrëshire pa fuga, rekomandohet

- përdorimi i sistemeve me rrëshirë me trashësi minimale 2 mm. Për të siguruar aplikimin e duhur dhe një sipërfaqe të vazhdueshme pa pore, këshillohet aplikimi i një shtrese të dyfishtë prajmeri, të përbërë nga Sikafloor®-03 Primer (aplikim me rull), në vazhdim një shtresë e dytë Sikafloor®-161 + 2% Extender T (si shtresë lëmimi). Monitoroni shtresën me prajmer që të siguroheni se nuk ka pore përpara aplikimit të llaçit të vetënivelueshëm ditën tjetër. Forca e ngjitjes e këtij kombinimi të prajmerave mbi Sikafloor®-300 Level duhet të jetë ~1.0N/mm².
- Nënshtrësas prej druri në kombinim me mbulimin nga pllakat qeramike duhet të jenë sistem i pangjitur, duke përdorur membranë ose shtresë izoluese. Për më tepër informacione këshillohuni me shërbimin teknik të Sika-s.
- Bazuar mbi rregulloret gjermane, për aplikimin vijues të llaçeve me bazë çimentoje të dyshemesë, përqindja e lagështisë së përmbajtur të tyre duhet të jetë ≤ 2.0 CM-% (për dysheme me ngrohje ≤ 1.8 CM-%), llaçe sulfati kalciumi (gipsi) duhet të ketë përmbajtje lagështie ≤ 0.5 CM-% (për dysheme me ngrohje ≤ 0.3 CM-%).

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikafloor®-300 Level
Mars 2019, Botimi 03.01
020815030010000153

Sikafloor-300Level-sq-AL-(03-2019)-3-1.pdf